

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier me objekt: “mbi procedurën e pranimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme” për periudhën 01/01/2010-31/12/2011” dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH nr. 125, datë 09/8/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01/6/2000, me shkresën nr. 451/11, datë 09/8/2012 dërguar **z. Dilaver KAMBERAJ**, regjistruer i ZVRPP Fier, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Nga ana e Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Udhëzuesin nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Kapitullin e II dhe të III “Dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim i paraqitur nga Agjencia Rajonale e ALUIZNI-t”, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Dokumentacioni për përfitimin e pronësisë së truallit si Kontrata e shitblerjes së truallit” në zbatim të VKM nr. 258, date 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të legalizuara”.

Argumentimi:

Në Udhëzuesin e Kryeregjistruesit me nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” në kapitullin e II dhe të III, “Dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim i paraqitur nga Agjencia Rajonale e ALUIZNI-t”, nuk është përfshirë dokumentacioni për përfitimin e pronësisë së truallit si Kontrata e shitblerjes së truallit në zbatim të VKM nr. 258, date 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të legalizuara”.

Për sa më sipër Udhëzuesi është në kundërshtim me:

1. Ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” me ndryshime,

1/a. kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore sipas nenit 17. “Kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore” ku përcaktohet shprehimisht: “...ALUIZNI, me vendim të Këshillit të Ministrave, ngarkohet të kryejë procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje”.

1/b. sipas nenit 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “d” ku përcaktohet shprehimisht: “vërtetimin ose certifikatën e pronësisë së parcelës ndërtimore nga ZRPP-ja përkatëse (pasi subjekti të jetë pajisur me të sipas këtij ligji, kur ai e disponon menjëherë gjatë vetëdeklarimit) dhe/ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë”.

2. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 4.5.2007, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara” Kreu II-Dokumentacioni i nevojshëm për kryerjen e

procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, pika 1, germa “a” ku përcaktohet shprehimisht: “Dokumentacionin ligjor-administrativ, lejen e legalizimit të ndërtimit pa leje”.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

- Për Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

1. Nga ana e Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme, në zbatim të kërkesave që përcaktohen në Kap IV, pikat 73, 74 dhe 80, të UMF, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, t’u kërkohet Zyrrave Rajonale, të kryejnë, një inventarizim të përgjithshëm të gjendjes së Hartave, Plansheteve, Librave, Volumeve, Kartelave etj, që ka në përdorim, sistemi i Zyrrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Menjëherë

2. Në kontratat individuale që lidhen ndërmjet Kryeregjistruesit dhe punonjësve, të ZVRPP në Rrethe, të përcaktohen edhe llojet e masave disiplinore sipas nenit 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet.

Menjëherë

- Për ZVRPP Fier

1. Regjistruesi në zbatim të nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të lëshojë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 66/23, me sipërfaqe 7974 m², volum 1, faqe 124, data e regjistrimit 29.9.2006, njëkohësisht për këtë pasuri ti dërgohet KV pranë Prefekturës Qarku Fier për të kryer shqyrtimin e ligjshmërisë të AMTP të regjistruar me nr. pasurie nr. 66/7, me sipërfaqe 12 000 m² e regjistruar në volum 1, faqe 105, regjistrim fillestar lëshuar certifikata e pronësisë më 22.8.2006.

Menjëherë

2. Regjistruesi ti dërgojë KV pranë Prefekturës Qarku Fier për shqyrtimin e ligjshmërisë të AMTP të dhëna me:

- AMTP nr. 33165 për sipërfaqen 16 000 m²;
- AMTP nr. 33167, për sipërfaqen 15 000 m²;
- AMTP nr. 33168, për sipërfaqen 15 000 m²;
- AMTP nr. 14665, datë 16.10.1996 për sipërfaqen 2 846 m² dhe
- AMTP nr. 31597, për sipërfaqen 16 000 m² të trajtuar në faqet 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

3. Nga ana e Zyrës së Financës të hapen analizat (partitarë) për llogaritë 468- Debitorë të ndryshëm, llogarinë 401-408- Furnitorë e llogari të lidhur me to dhe llogaria 467 - Kreditorë të ndryshëm. Sipas kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 2 germa c-Dokumentet e kontabilitetit, pika 2.3 -Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

Menjëherë

4. Në të ardhmen Formularët e Aplikimeve të plotësohen me të gjitha rubrikat e përcaktuara, duke vendosur emrin dhe mbiemrin e plotë të punonjësit që ka përpunuar dosjen. Ndërsa në aplikimet në formë elektronike të plotësohet për secilin rast rubrika “Data e marrjes së përgjigjes”.

Menjëherë

5. Në shënimet dhe ndryshimet që do të bëhen në kartelat e pasurisë, librat e regjistrimit, harta treguese etj, dokumente të ZVRPP, të vendoset emri, mbiemri dhe nënshkrimi i qartë i punonjësit i cili ka kryer përpunimin e referencës dhe datën e kryerjes së veprimit.

Menjëherë

6. Në zbatim të Kreut 3, “Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme”, pika 1.2 të UMF nr. 12, datë 18.5.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, për pasuritë të cilat do të rivlerësohen nga ekspertët, me Raport vlerësimi të pasurisë së paluajtshme, për secilin aplikim të bashkëlidhet fotokopja e Licencës së personit fizik apo juridik.

Menjëherë

7. Të inventarizohen të gjitha praktikat e rivlerësimeve të pasurive të paluajtshme, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregullores së nxjerrë për këtë qëllim.

Menjëherë

8. Nga ana e ZVRPP, Fier të kryhet një inventarizim i përgjithshëm i gjendjes së Hartave, Plansheteve, Librave, Volumeve, Kartelave etj, që ka në përdorim sistemi i Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Menjëherë

Në Zonën Urbane:

Regjistruesi i ZVRPP, Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për 3 pasuritë e mëposhtme:

9. **Për pasurinë nr. 8/53, ZK 8534, vol 4, fq. 170, Hipoteka nr. 243, datë 15.4.2005, në emër të qytetares .** ■ pasi ka mbivendosje për sipërfaqen 171 m² me pronën e Bashkisë Fier.

Menjëherë

10. **Për pasurinë nr. 4/23, ZK 8534, me numër Reference 0002735 me sipërfaqe ndërtimi 220 m² në lagjen “Kastriot”, kufizimi vetëm për bodrumin pasi regjistrimi i tij është bërë pa dokument, ndërkohë nuk është edhe në vendimin e KRRT, të Bashkisë Fier nr. 01, datë 22.3.1999, leje për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane dhe Vendimin e KRRT-së, Fier nr. 3, datë 25.6.1999 për leje ndërtimi. Në akt kolaudimin datë 30.10.2007, mungon sipërfaqja e katit përdhe.**

Menjëherë

11. **Për pasurinë nr. 8/297, Vol 18, Fq. 23, Z.K. 8531, me numër Reference 0006172, pasi kontrata e shitjes datë 30.7.1996, të sektorit të mjeteve të ndërmarrjes së bukës Fier, të lidhur ndërmjet Shitësit Dega AKP, Fier për blerjen e sipërfaqes tokës prej 5003 m², e cila nuk është lidhur para noterit, në kundërshtim me nenin 83 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.**

Menjëherë

Në Zonën Rurale

12. Zona Kadastrale 2274, fshati Kreshpan.

Regjistruesi i ZVRPP, Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33/ 2012 datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara për AMTP si më poshtë vijon:

- **AMTP nr. 27076, datë 16.10.1995, me sipërfaqe 11950 m² tokë, në emër të shtetasit** ■ regjistruar pasuria nr. 129/11, Volumi 1, faqe 248.

- **AMTP nr. 27204, datë 16.10.1995**, me sipërfaqe 13500 m² tokë, në emër të shtetasit ■■■ ku është regjistruar pasuria nr. 198/17, volumi 1, faqe 248, sipërfaqja 2500 m² tokë “ullishte”.

- **AMTP nr. 27024, datë 16.10.1995**, me sipërfaqe 13500 m² tokë, në emër të shtetasit ■■■ ku është regjistruar pasuria nr. 129/10, volumi 1, faqe 239, sipërfaqja 250 m² truall dhe 72 m², ndërtesë.

- **AMTP nr. 27524, datë 16.6.1996**, me sipërfaqe 16630 m² tokë, në emër të shtetasit ■■■ ku është regjistruar pasuria nr. 228/2, volumi 6, faqe 234, sipërfaqja 560 m² ullishte dhe nr. 227/79. Volumi 4. faqe 79.

- **AMTP nr. 27078, datë 16.10.1998**, me sipërfaqe 11610 m² tokë, në emër të shtetasit ■■■

- **AMTP nr. 27240, datë 16.10.1995**, me sipërfaqe 11510 m² tokë, në emër të shtetasit ■■■

- **AMTP nr. 27240 datë 16.10.1995**, me sipërfaqe 11510 m² tokë, në emër të shtetasit ■■■ pasuria nr. 227/30. Volumi 3. faqe 5, sipërfaqe 600 m² tokë arë me referencë 00084.

Menjëherë

13. Zona Kadastrale nr. 5816, fshati Varibop.

Regjistruesi i ZVRPP , Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33/ 2012 datë 21.3.2012 “ Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të regjistruara në ZK 5816 si më poshtë vijon:

- **AMTP nr. 1256, datë 13.5.1996**, në emër të shtetasit ■■■

- **AMTP nr. 1346, datë 22.5.2007**, në emër të shtetasit ■■■

-**AMTP nr. 1257, datë 22.5.2007**, në emër të shtetasit ■■■

-**AMTP nr. 1346, datë 22.5.2007** në emër të shtetasit regjistruar pasurin nr. 297/1. volumi 5, faqe 143.

Menjëherë

14. Zona Kadastrale 1341, Fshati Buzmadh.

Regjistruesi i ZVRPP, Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33/ 2012 datë 21.3.2012 “ Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të regjistruara në ZK 1341 si më poshtë vijon:

- **AMTP nr. 14107, datë 22.9.1994**, me sipërfaqe 11460m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 744 në Volumi 3, faqe 244.297/1.

- **AMTP nr. 14056, datë 28.9.1994**, me sipërfaqe 12360 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 1729, Volumi 7, faqe 229.

- **AMTP nr. 14058, datë 28.9.1994**, me sipërfaqe 6590 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 1724, Volumi 7, faqe 224.

-**AMTP nr. 14056, datë 28.9.1994**, me sipërfaqe 12360 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 1729, Volumi 7, faqe 229.

- **AMTP nr. 14060, datë 28.9.1994**, me sipërfaqe 15375 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 1722, Volumi 7, faqe 222.

- **AMTP nr. 14260, datë 23.8.2008**, me sipërfaqe 19090 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 923, Volumi 11, faqe 204; sipërfaqja 1600 m² tokë arë, 7 rrënjë ulli dhe 250 m² tokë truall me referencë nr. 000215.

-**AMTP nr. 14189, datë s’ka**, me sipërfaqe 21180 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 932, Volumi 4, faqe 182, sipërfaqja 2000 m² tokë “arë”, 7 rrënjë “ulli”, 250 m² tokë “truall” dhe 75 m² ndërtesë , me referencë nr. 000267.

- **AMTP nr. 14260, datë**, me sipërfaqe 11590 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 2682, Volumi 11, faqe 181; sipërfaqja 370 m² tokë “arë”, 320 m² tokë “ullishte” dhe 250 m² tokë “truall”, me referencë nr. 000295;

Menjëherë

15. Zona Kadastrale 3981, Fshati Sheq.

Regjistruesi i ZVRPP Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të regjistruara në ZK 3981 si më poshtë vijon:

-**AMTP nr. 30728, datë 20.6.2008**, me sipërfaqe 4000 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 25/8, Volumi 5, faqe 183; sipërfaqja 3812 m² tokë “arë”.

- **AMTP nr. 30729, datë 20.6.2008**, me sipërfaqe 4000 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 25/9, Volumi 5, faqe 184; sipërfaqja 3813 m² tokë “arë”.

-**AMTP nr. 30729, datë s’ka**, me sipërfaqe 11770 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 164, Volumi 4, faqe 59; sipërfaqja 3813 m² tokë “arë”.

-**AMTP nr. 29959, datë 20.5.1995**, me sipërfaqe 4000 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 277/7, Volumi 2, faqe 186; sipërfaqja 3925 m² tokë “arë”.

Menjëherë

16. Zona Kadastrale 3980, fshati “Mbrostar Ferko”.

Regjistruesi i ZVRPP Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33/ 2012 datë 21.3.2012 “ Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të regjistruara në ZK 3980 si më poshtë vijon:

- **AMTP nr. 26200, datë s’ka**, me sipërfaqe 4000 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurinë nr. 16/2/1, Volumi 1, faqe 117, sipërfaqja 3915 m² tokë arë.

Menjëherë

17. Zona Kadastrale 1414, Fshati “Çlirim”.

Regjistruesi i ZVRPP Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33/ 2012 datë 21.3.2012 “ Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të regjistruara në ZK 1414 si më poshtë vijon:

- **Pasuria nr. 36/28, Volumi 7, faqja 154**, në emër të shtetasit ■■■ Regjistruar pasuria truall sipërfaqja 200 m² nga kjo, ndërtesë 72 m².

Ti kërkohet shtetasit ■■■ dhe Komunës Qendër Fier, për plotësimin e dokumentacionit për burimin e pronësisë që ka përfituar ky shtetas, ku rezultoi se: Nuk ka vërtetim pronësie, por ka një listë emërore të trojeve dhe banesave të qytetarëve në fshatin Çlirim pa firmë dhe pa vulë.

Ky kufizim të zgjasë deri në momentit e plotësimit të dokumentacionit (vërtetimin e pronësisë nga Komuna Qendër).

-**AMTP datë 26.09.2006** me sipërfaqe 4300 m² në emër të shtetasit ■■■ regjistruar pasurin nr. 249/3, Volumi 11, faqe 117, sipërfaqja 4300 m² tokë “arë”.

Menjëherë

18. Zona Kadastrale 2443. Fshati Libofshë.

-Pasuria nr. 151/21, Vol. 10, faqe. 168, në emër të shtetasit ■■■

-Pasuria nr. 38/5, Volumi 12 faqja 110 shtëpi banimi me sipërfaqe 68 m² në emër të shtetasit Bajram Dema.

Menjëherë

19. NB “AFRIM” Zona Kadastrale 3984.

Regjistruesi i ZVRPP Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33/ 2012 datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të regjistruara në ZK 3984 si më poshtë vijon:

- **AMTP nr. 33505, datë 01.10.2002**, me sipërfaqe 3500 m² në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuria nr. 375, volumi 2, faqja 228; sipërfaqja 3500 m² tokë “arë”. Nga ana e ZVRPP Fier të kërkohet, saktësimi për:

- Plan vendosjen e shkallës 1: 2500 e cila është pa sipërfaqe;

- Plani i rilevimit objekti tokë “arë” sipërfaqja 3500 m² është pa numër pasurie dhe pa treguesit e hartës.

- **AMTP nr. 33504, datë 01.10.2002**, me sipërfaqe 3500 m² në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuria nr. 35/1, volumi 2, faqja 129; sipërfaqja 3500 m² tokë “arë”. Nga ana e ZVRPP Fier të kërkohet, saktësimi për:

- Plan vendosjen me shkallën 1: 2500 e cila është pa sipërfaqe;

- Plani i rilevimit objekti tokë “arë” sipërfaqja 3500 m² është pa numër pasurie dhe pa treguesit e hartës.

- **AMTP nr. 33505, datë 01.10.2002**, me sipërfaqe 3500 m² në emër të shtetasit ■ regjistruar pasurinë nr. 377, volumi 2, faqja 130; sipërfaqja 3500 m² tokë “arë”.

- **AMTP nr. 32840, datë 31.3.2003.20** me sipërfaqe 1200 m² në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuria me nr. 271, volumi 2, faqja 21; sipërfaqja 1200 m² tokë “arë”.

- **AMTP nr. 33499, datë 31.3.2003**, me sipërfaqe 1350 m² në emër të shtetasit ■ i regjistruar në pasurinë nr. 259, volumi 9, faqja 9, sipërfaqja 1350 m² tokë “arë”.

- **AMTP nr. 32972**, me sipërfaqe 1000 m² në emër të shtetasit ■ regjistruar pasurin pasuria nr. 122, volumi 2, faqja 122; sipërfaqja 1000 m² tokë “arë”.

Menjëherë

20. Për regjistrimet e veçanta.

Regjistruesi i ZVRPP Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33/ 2012 datë 21.3.2012 “ Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të regjistruara në ZK 2274 si më poshtë vijon:

- **AMTP nr. 16743, datë 20.3.2008**, në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuria nr. 269/10 volum 1, faqe 6 me sipërfaqe 1000 m² tokë “arë”

- **AMTP nr. 16749, datë 21.02.2007**, në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuria nr. 269/12 volum 1, faqe 5 me sipërfaqe 3100 m² tokë “arë”.

- **AMTP nr. 18555, datë 05.02.2001**, në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuria nr. 126/6, volum 1, faqe 136, me sipërfaqe 4000 m² tokë “arë”.

- **AMTP nr. 13804, datë 05.4.2001** me sipërfaqe 3100 m² tokë, në emër të shtetasit ■ ku është regjistruar pasuria nr. 269, Volumi 1, faqe 2, sipërfaqja 3100 m² tokë “arë”. Nga ana e Kryeregjistruesit me shkresën nr. 710, datë 23.03.2010, është miratuar ky regjistrim.

- **AMTP nr. 16747, datë 06.01.1995**, në emër të shtetasit B.S., regjistruar pasuria nr. 269/4, volum 1, faqe 4, me sipërfaqe 1000 m² tokë “arë”

- **AMTP nr. 16756, datë 06.01.1995**, në emër të shtetasit A.S., regjistruar pasurit nr. 269/11, volum 1, faqe 2 dhe 269/7 volumi 1 faqe 3, 269/11, sipërfaqja 1000 m², tokë “arë” dhe pasuria 269/7 sipërfaqja 2700 m² tokë “arë”.

Menjëherë

21. Auditim mbi mënyrën e regjistrimit fillestar me 001, në zbatim të VKM nr. 432, datë 14.8.1995 “Për regjistrimin sipas listës emërore të pronarëve të trojeve dhe të shtëpive”.

Regjistruesi i ZVRPP Fier, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të kufizojë pasuritë e regjistruara si më poshtë vijon:

- **AMTP nr. 27188, datë 16.10.1998**, me sipërfaqe 4560 m² tokë në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuria 235/6, volumi 2 faqe 105, sipërfaqja 1900 m² tokë “arë” dhe 250 m² tokë “truall”.

- **Pasuria 235/6**, sipërfaqja 1900 m², nga kjo 250 m² tokë “truall”, është e pa plotësuar me kufitar, në dosje mungonte lista emërore (001). Kjo pasuri është regjistruar dhe pajisur me certifikatë me sipërfaqe 1900 m², nga kjo 300 m² tokë “truall”, ose 50 m² tokë “truall” më tepër dhe ndërtesë 81 m²,

- **Pasuria 240/147**, sipërfaqja 560 m² tokë “ullishte” është e pa plotësuar me kufitar.

- Pasuria 127, sipërfaqja 980 m² tokë “ullishte” është e pa plotësuar me kufitar.

- Pasuria 34, sipërfaqja 3250 m² tokë “ullishte” është e pa plotësuar me kufitar.

Kufizimi të mbështetet bazuar në shkresën nr. 6287/3, datë 26.10.2010, të Kryeregjistruesit, ZQRPP Tiranë, ku ka kërkuar që për çdo rast kur regjistrimet janë bërë në bazë të listës emërore të pronarëve të trojeve dhe të shtëpive (001) pas hyrjes në fuqi të pikës 5, të VKM nr. 159, datë 21.03.2006, të urdhërohet vendosja e kufizimit të veprimeve, në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe deri në momentin e marrjes së vendimit të KV Fier për pavlefshmërinë ose vlefshmërinë e AMTP dhe fshirjen e sipërfaqes 50 m² tokë “truall” më tepër.

- **AMTP nr. 14317, datë 28.9.1994**, me sipërfaqe 4400 m² tokë në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuria nr. 2139, volumi 9 faqe 139 referencë nr. 000196, sipërfaqja 3948 m² tokë “arë” dhe 250 m² tokë “truall” dhe 90 m² ndërtesë.

- **AMTP nr. 14702, datë 21.6.2008**, me sipërfaqe 3300 m² tokë në emër të shtetasit ■ regjistruar pasuritë 2663, volumi 11 faqe 158 referencë nr. 000196- 172, sipërfaqja 3300 m² tokë “arë” dhe 250 m² tokë “truall” dhe 90 m² ndërtesë.

- **AMTP nr. 14317, datë 28.9.1994**, me sipërfaqe 4400 m² tokë në emër të shtetasit ■ regjistruar pasurit 2139, volumi 9 faqe 139 referencë nr. 000196, sipërfaqja 3948 m² tokë “arë” dhe 250 m² tokë “truall” dhe 90 m² ndërtesë.

- **AMTP nr. 14702, datë 21.6.2008**, me sipërfaqe 3300 m² tokë në emër të shtetasit ■ regjistruar pasurit 2663, volumi 11 faqe 158 referencë nr. 000196- 172, sipërfaqja 3300 m² tokë “arë” dhe 250 m² tokë “truall” dhe 90 m² ndërtesë.

- **Pasurin nr. 18/2 , Volumi 5, faqe 194**, në emër të shtetasit ■

Menjëherë

22. Regjistruesi me urdhër të brendshëm të vendosë kufizimin në seksionin E të kartelave të pasurive dhe ti dërgoj komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë (KV) në Prefekturën e Qarkut Fier, gjithë AMTP e trajtuara në Projektraportin e auditimit për të cilat rezultojnë të meta e mangësi, me anë të një relacioni i cili duhet të përmbajë gjithë problematikën e trajtuar për argumentimin e paligjshmërisë së konstatuar dhe propozimin për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore si më poshtë:

ZK 3979

- AMTP nr. 33165, pa datë, sipërfaqe 16666 m²;

- AMTP nr. 33167, pa datë, sipërfaqe 15000 m²;

- AMTP nr. 33168, pa datë, sipërfaqe 15000 m²;

- AMTP nr. 14665, datë 16.10.1996, sipërfaqe 2846 m²;

Patos

- AMTP nr. 31596, pa datë, sipërfaqe 16000 m²;

- AMTP nr. 31597, pa datë, sipërfaqe 16000 m²;
- AMTP nr. 31598, pa datë, sipërfaqe 16000 m²;
- AMTP nr. 31599, pa datë, sipërfaqe 16000 m².
- Pasurinë nr. 66/23, me sipërfaqe 7974 m², volum 1, faqe 124, ZK 2890.

Menjëherë

23. Të korrigojohet kartela e pasurisë së paluajtshme nr. pasurie 2/353, volum 1, faqe 157, sipërfaqja totale e pasurisë nga 890 m² truall në 1808 m², për arsye se nga veriperëndimi sheshi i ndërtimit cenohet nga trotuari për 60 m² dhe nga jugu 22 m², gjithsej 82 m².

Menjëherë

24. Zyra Vendore Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të mos bëjë regjistrim të pasurive të paluajtshme të ardhura nga ALUIZNI, në rastet kur sipërfaqja e truallit të përcaktuar nga ANLUIZN-i për regjistrim është më e vogël se sipërfaqja e përcaktuar në VKM-në përkatëse, për kalimin e pronësive të parcelave ndërtimore.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

1. Në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ti propozohet Ministrit të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të regjistruesit ■■■ për arsye se:

Nuk ka zbatuar urdhrin e ZQRPP e cila me shkresën nr. 4851/1, datë 16.7.2008 “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ka kërkuar ZVRPP Fier që të vendosë kufizimin e veprimeve mbi pasurinë nr. 66/7, ZK 2890, regjistruar në pronësi të shtetasit ■■■ në zbatim të procedurës së regjistrimeve të veçanta, miratuar me shkresën nr. 859/1, datë 02.5.2006 të ZQRPP, me sipërfaqe 12 000 m², e regjistruar në volum 1, faqe 105, për të cilën është lëshuar dhe certifikata e pronësisë më 22.8.2006.

Kjo pasuri me referencë 00159, datë 29.9.2006, është ndarë në tre pasuri si më poshtë:

- Pasuria me nr. 66/2, me sipërfaqe 506 m², e regjistruar në volum 1, faqe 123, datë e regjistrimit 29.9.2006 dhe data e lëshimit të certifikatës 29.9.2006.
- Pasuria nr. 66/22, me sipërfaqe 3520 m², e regjistruar në volum 1, faqe 123, datë e regjistrimit 29.9.2006 dhe data e lëshimit të certifikatës 29.9.2006.
- Pasuria nr. 66/23, me sipërfaqe 7974 m², e regjistruar në volum 1, faqe 124, data e regjistrimit 29.9.2006 dhe data e lëshimit të certifikatës 29.9.2006.

Në zbatim të urdhrin të ZQRPP Tiranë, ZVRPP Fier ka nxjerrë urdhrin nr. 1483, datë 23.7.2008, për kufizimin e pasurisë nr. 66/7. Punonjësja e ZVRPP Fier, ■■■ me detyrë juriste, ka regjistruar kufizimin vetëm në kartelën mëmë por nuk ka bërë të njëjtën gjë me kartelat bijë të saj, duke vepruar kështu në kundërshtim me urdhrin e mësipërm.

Për pasojë më datën 25.01.2011 është kryer kontratë shitje për pasurinë me nr. 66/21, me sipërfaqe 506 m², me blerës z. ■■■, e regjistruar dhe pajisur me certifikatë pasurie më datën 25.01.2011.

2. Mbështetur në nenin 143 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime dhe Kontratën Individuale të Punës, ti rekomandojmë Kryeregjistruesit të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. “Zgjidhje të kontratës së punësimit” për:

1. ■ në cilësinë e juristes pasi:

Nuk ka zbatuar urdhrin e ZQRPP e cila me shkresën nr. 4851/1, datë 16.7.2008 “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ka kërkuar ZVRPP Fier që të vendosë kufizimin e veprimeve mbi pasurinë nr. 66/7, ZK 2890, regjistruar në pronësi të shtetasit ■ në zbatim të procedurës së regjistrimeve të veçanta, miratuar me shkresën nr. 859/1, datë 02.5.2006 të ZQRPP, me sipërfaqe 12 000 m², e regjistruar në volum 1, faqe 105, për të cilën është lëshuar dhe certifikata e pronësisë më 22.8.2006.

Kjo pasuri me referencë 00159, datë 29.9.2006, është ndarë në tre pasuri si më poshtë:

- Pasuria me nr. 66/2, me sipërfaqe 506 m², e regjistruar në volum 1, faqe 123, datë e regjistrimit 29.9.2006 dhe data e lëshimit të certifikatës 29.9.2006.

- Pasuria nr. 66/22, me sipërfaqe 3520 m², e regjistruar në volum 1, faqe 123, datë e regjistrimit 29.9.2006 dhe data e lëshimit të certifikatës 29.9.2006.

- Pasuria nr. 66/23, me sipërfaqe 7974 m², e regjistruar në volum 1, faqe 124, data e regjistrimit 29.9.2006 dhe data e lëshimit të certifikatës 29.9.2006.

Në zbatim të urdhrin të ZQRPP Tiranë, ZVRPP Fier ka nxjerrë urdhrin nr. 1483, datë 23.7.2008, për kufizimin e pasurisë nr. 66/7. Punonjësja e ZVRPP Fier, ■ me detyrë juriste, ka regjistruar kufizimin vetëm në kartelën mëmë por nuk ka bërë të njëjtën gjë me kartelat bijë të saj, duke vepruar kështu në kundërshtim me urdhrin e mësipërm.

Për pasojë më datën 25.01.2011 është kryer kontratë shitje për pasurinë me nr. 66/21, me sipërfaqe 506 m², me blerës z. ■ e regjistruar dhe pajisur me certifikatë pasurie më datën 25.01.2011.

- Nuk ka kryer verifikimin e kontratës së shitjes datë 30.7.1996, të sektorit të mjeteve të ndërmarrjes së bukës, Fier, të lidhur ndërmjet Shitësit Dega AKP, Fier dhe qytetarit ■ Megjithëse kjo kontratë nuk është kryer me akt noterial në kundërshtim me nenin 83 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i R.SH” me ndryshime, juristja ■ më datën 23.12.2011, i ka lëshuar vërtetim hipotekar qytetarit ■ se ka në pronësi pasurinë numër 8/297, Vol 11, F. 12 ndodhur në ZK 8531 me sipërfaqe 5003 m², veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.04.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren e Brendshme nr. 184, datë 08.04.1999, kreu IV, pika 16, urdhrin nr. 37, datë 06.06.2000 “Për zbatimin e nenit 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.04.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- Ka pranuar 26 praktika rivlerësimi pasurie pa u paraqitur fotokopja e licencës së vlerësuesit të pasurisë, në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 12, datë 18.5.2011” Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 ”Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, Kreu 3, -Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme, pika 1.2 dhe rregulloren nr. 184, datë 4.8.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pikat 9 dhe 10, ndryshuar me nr. 7, datë 7.01.2000, përkatësisht: pika , 7 - Arkiva, pika 8, -Financa dhe pikën , 9 -Pritja e popullit.

b. “Vërejtje me paralajmërim”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. ■, me detyrë juriste pasi;

-nuk ka kryer verifikimin e kontratës së shitjes datë 30.7.1996, të sektorit të mjeteve të ndërmarrjes së bukës, Fier, të lidhur ndërmjet Shitësit Dega AKP, Fier dhe qytetarit ■ Megjithëse kjo kontratë nuk është kryer me akt noterial, në kundërshtim me nenin 83 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 ”Kodi Civil i R.SH” me ndryshime, juristja, ■ më datën 15.3.2011 i

ka lëshuar vërtetimi hipotekor, qytetarit ■ se ka në pronësi pasurinë me numër 8/75 të ndodhur në ZK 8531, të një sipërfaqe prej 3193 m² truall dhe një pjesë e sektorit të automjeteve. Veprim ky në kundërshtim edhe me ligjin nr. 7843, datë 13.04.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren e Brendshme nr. 184, datë 08.04.1999, kreu IV, pika 16, urdhrin nr. 37, datë 06.06.2000 “Për zbatimin e nenit 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.04.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

-ka pranuar 3 praktika rivlerësimi pasurie pa u paraqitur fotokopja e licencës së vlerësuesit të pasurisë, në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 12, datë 18.5.2011” Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 ”Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, Kreu 3, -Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme, pika 1.2. dhe rregulloren nr. 184, datë 4.8.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pikat 9 dhe 10, ndryshuar me nr. 7, datë 7.01.2000, përkatësisht: pika , 7 -Arkiva, pika 8, -Financa dhe pikën , 9 -Pritja e popullit.

2. ■ juriste, pasi nuk ka kryer verifikimin e kontratës së shitjes datë 30.7.1996, të sektorit të mjeteve të ndërmarrjes së bukës, Fier, të lidhur ndërmjet Shitësit Dega AKP, Fier dhe qytetarit ■ Megjithëse kjo kontratë nuk është kryer me akt noterial në kundërshtim me nenin 83 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 ”Kodi Civil i R.SH” me ndryshime, juristja ■ më datën 03.11.2011, i ka lëshuar vërtetimin hipotekor nr. 326, qytetarit ■ se ka në pronësi pasurinë numër 8/74 ndodhur në ZK 8531, për rishitje të sipërfaqes prej 1810 m². Veprim ky në kundërshtim edhe me ligjin nr. 7843, datë 13.04.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren e Brendshme nr. 184, datë 08.04.1999, kreu IV, pika 16, urdhrin nr. 37, datë 06.06.2000 “Për zbatimin e nenit 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.04.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” .

-pasi, më datën 17.11.2010 ka kryer veprime për Pasurinë nr. 8/53 me firmën “■” duke hipotekuar sipërfaqen e pronës 588 m², prej të cilave 77 m² banesë, e cila ndodhet në ZK 8534. Ndërkohë që prona ka qenë me mbivendosje për sipërfaqen 171m² me pronën e Bashkisë Fier e cila është konstatuar nga specialistët e ZVRPP Fier më datë 16.11.2005.

Kryerja e veprimeve të mësipërme është bërë pa u paraqitur tek noteri, në kundërshtim me nenin 83 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994” Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”. Po kështu regjistrimi i pronës është bërë pa u miratuar nga Këshilli Bashkiak Fier, në kundërshtim me nenin 32 germa (e) të ligjit nr. 8552, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore”.

3. ■ juriste në cilësinë e pritëses në sportel dhe përpiluese dokumentacioni për regjistrim, pasi:

-ka pranuar 8 praktika rivlerësimi pasurie pa u paraqitur fotokopja e licencës së vlerësuesit të pasurisë, në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 12, datë 18.5.2011” Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 ”Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, Kreu 3, -Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme, pika 1.2. dhe rregulloren nr. 184, datë 4.8.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pikat 9 dhe 10, ndryshuar me nr. 7, datë 7.01.2000, përkatësisht: pika , 7 -Arkiva, pika 8, -Financa dhe pikën , 9 -Pritja e popullit.

- Ka pranuar dokumentacionin dhe ka kryer veprime për regjistrime fillestare në 6 raste, ku dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi kanë qenë jo të rregullta si:

- AMTP në vetvete në 6 pasuri me sipërfaqja 2400 m² tokë “arë”, 1580 m² tokë “ullishte” dhe 750 m² tokë “truall” janë të pa plotësuar me kufitarët;

- Ka kryer regjistrim fillestar kur pasuria në 3 raste nuk ka fare nr.--- pasurie.
- në 6 pasuri të aplikuar, planet e riveimit dhe të vendosjet janë të pa firmosur nga aplikuesi.
- në 1 rast Kryetari i Komisionit të ndarjes tokave, nuk ka firmosur AMTP.
- Ka pranuar duke kryer veprimet për aplikuesi ■ i cili ka paraqitur dy “AMTP” si:
 - AMTP nr. 1340, sipërfaqja totale 18820 m² tokë “arë” dhe 250 m² tokë “truall”;
 - AMTP nr. 1340, sipërfaqja totale 19070 m² tokë “arë”;
 - Pasuria 100, tek “AMTP” datë 31.08.2006 është 1100 m² tokë arë;
 - Pasuria 100, tek “AMTP” datë 13.04.1997 është 850 m² tokë dhe 250 m² truall;
 - AMTP kanë data të ndryshme dhe në të dy rastet janë pa kufitarë;

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56, të ligjit 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar ,Udhëzimit të KM nr. 1 datë 31.01.2007, “Për procedurat e regjistrimit në ZVRPP” dhe Udhëzimi KM nr. 2, datë 8.4.2009, “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme të fituara me AMTP” dhe Urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 61, datë 02.8.1999, “Për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme në raste të veçanta”

4. Entela Shqepa, me detyrë juriste pasi;

Në regjistrimin e pasurisë nr. 4/23 ndodhur ZK 8534, me numër Reference 0002735, në emër të qytetarit ■ me sipërfaqe ndërtimi 220 m² në lagjen “Kastriot”. U konstatua se nuk janë respektuar afatet e regjistrimit, pasi aplikimi është bërë përkatësisht me numrat, 59, 60, 61 dhe 62 më datën 23.1.2008. Ndërkohë procedura e regjistrimit ka filluar pas 2 vjetësh, me dokumentin hipotekar nr. 495, datë 16.4.2010 dhe juristja ■ i ka kaluar në pronësi ■ apartamente me sipërfaqe 241 m², në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me ndryshime.

- nuk ka plotësuar të dhënat e planit të rivelimit, në ZK 2890, Patos, të qytetares ■ data e aplikimit 30.09.2010, Volumi 14, Faqe 60, objekti Farmaci + Bar Internet, me sipërfaqe 101 m², Farmacia dhe shtesa e katit dytë 64.8 m², dërguar dokumentacioni i regjistrimit me shkresën nr. 792, datë 02.09.2010.
- nuk ka plotësuar të dhënat e planit rivelimit në ZK 2890, Patos, të qytetarit ■ data e aplikimit 10.5.2010, Volumi 16, Faqe 41, Objekti, shtesë kat mbi objektin ekzistues. Kati i parë banesë 82 m², dërguar dokumentacioni i regjistrimit me shkresën nr. 365, datë 28.3.2010.

5. ■ me detyrë hartografe pasi:

- Më datën 17.11.2010 ka kryer veprime për Pasurinë nr. 8/53 me firmën “■” duke hipotekuar sipërfaqen e pronës 588 m², prej të cilave 77 m² banesë, e cila ndodhet në ZK 8534. Ndërkohë që prona ka qenë me mbivendosje për sipërfaqen 171m² me pronën e Bashkisë Fier e cila është konstatuar nga specialistët e ZVRPP Fier më datë 16.11.2005.

Kryerja e veprimeve të mësipërme është bërë pa u paraqitur tek noteri, në kundërshtim me nenin 83 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994” Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”. Po kështu regjistrimi i pronës është bërë pa u miratuar nga Këshilli Bashkiak Fier, në kundërshtim me nenin 32 germa (e) të ligjit nr. 8552, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore”, shkronja (e),

- nuk ka plotësuar të dhënat e planit të rivelimit, në ZK 2890, Patos, të qytetares ■ data e aplikimit 30.09.2010, Volumi 14, Faqe 60, objekti Farmaci + Bar Internet, me sipërfaqe 101 m², Farmacia dhe shtesa e katit dytë 64.8 m², dërguar dokumentacioni i regjistrimit me shkresën nr. 792, datë 02.09.2010.

- nuk ka plotësuar të dhënat e planit riveimit në ZK 2890, Patos, të qytetarit ■ data e aplikimit 10.5.2010, Volumi 16, Faqe 41, Objekti, shtesë kat mbi objektin ekzistues. Kati i parë banesë 82 m², dërguar dokumentacioni i regjistrimit me shkresën nr. 365, datë 28.3.2010.

6. ■ me detyrë jurist, pasi:

-Ka pranuar dokumentacionin dhe ka kryer veprime për regjistrime fillestare në 12 raste dhe në regjistrimet e veçanta 3 raste, ku dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi kanë qenë të pa rregullta si:

- AMTP në vetvete në 14 pasuri me sipërfaqja 10,090 m² tokë “ullishte” , 690 m² tokë “arë” dhe 1750 m² tokë “truall” janë të pa plotësuar me kufitarët;

-Ka kryer regjistrim fillestar kur pasuria nuk ka fare nr. pasurie, si më poshtë:

- në 9 raste, planet e riveimit dhe planvendosjet janë të pa firmosur nga aplikuesi.

- në 2 raste AMTP janë pa vulën e Bashkisë apo Komunës.

- në 2 raste në komisionin e ndarjes tokave, nuk ka firmosur AMTP.

- në 2 raste mungon lista emërore e (001).

- Ka kryer regjistrimin e pasurisë nr. 227/30. Volumi 3. Faqe 5, me referencë 00084; për sip. 600 m² tokë “arë” e pa plotësuar me kufitarët;

- Plani i riveimit është pa kufitar;

- Plan vendosja është pa kufitar;

- Nuk ka asnjë deklaratë kufitarësh;

- Ka kryer regjistrimin e pasurisë nr. 151/21 ,Volumi 10, Faqja 168, në dosje mungon shpallja që kjo pasuri nuk ka konflikt pronësie dhe deklarata e kufitarëve.

- në 3 praktika të regjistruara për regjistrime të veçanta, nuk ka përputhje midis kërkesës për regjistrim nga ZVRPP Fier, me atë të miratuar nga Kryeregjistruesi, për numrin e AMTP, si dhe të metat në vendosjen e kufitarëve si:

Në AMTP nr. 13804 për sipërfaqen 400 m² tokë nga këto 150 m² tokë “arë” dhe 250 m² tokë “truall”: Për zërat e pasurive:

- nr. 163/3, sipërfaqja 400 m² tokë, nuk janë vendosur kufitarët.

- nr. 536, sipërfaqja 27 rrënjë m² “ulli” nuk janë vendosur kufitarët.

Pasuria me nr. 269/2 është regjistruar në volum 1, faqe 2 me dokumentacion shoqëruës jo të rregullt.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56, të ligjit 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar ,UKM nr. 1 datë 31.01.2007, “Për procedurat e regjistrimit në ZVRPP” dhe UKM nr. 2 , datë 8.4.2009, “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme të fituara me AMTP” dhe Urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 61, datë 02.8.1999, “Për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme në raste të veçanta”

7. ■ me detyrë Juriste, pasi;

- Ka pranuar dokumentacionin dhe ka kryer veprime për regjistrime fillestare në 7 raste dhe në regjistrimet e veçanta në 6 raste, ku dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesit nuk kanë qenë të rregullta, si:

- AMTP në vetvete në 5 pasuri me sipërfaqja 6860 m² tokë “ullishte” , 4370 m² tokë “arë” dhe 500 m² tokë “truall” janë të pa plotësuar me kufitarët;

- Ka kryer regjistrim fillestar kur pasuria nuk ka fare nr. pasurie.

- në 9 pasuri të aplikuara, planet e riveimit dhe të vendosjet janë të pa firmosur nga aplikuesi.

- në 2 raste kryetari i komisionit të ndarjes tokave, nuk ka firmosur AMTP.

- në 6 praktika të regjistruara nuk ka përputhje midis kërkesës për regjistrim nga ZVRPP Fier, me atë të miratuar nga Kryeregjistruesi, për numrin e AMTP, si dhe të metat në vendosjen e kufitareve si:

Në AMTP nr. 16747, për sipërfaqen 19250 m² tokë “arë”.

Për zërat e pasurit:

- nr. 307/2 sipërfaqja, 750 m² tokë “arë” nuk janë vendosur kufitarët.
- nr. 265 sipërfaqja, 1000 m² tokë “arë” nuk janë vendosur kufitarët.
- nr. 280/3 sipërfaqja, 1200 m² tokë “arë” nuk janë vendosur kufitarët.
- nr. 304 sipërfaqja, 600 m² tokë “arë” nuk janë vendosur kufitarët.
- nr. 308 sipërfaqja 400 m² tokë “arë” nuk janë vendosur kufitarët.
- nr. 304 sipërfaqja 2500 m² tokë “arë” nuk janë vendosur kufitarët.
- nr. 308 sipërfaqja 1700 m², tokë “arë” nuk janë vendosur kufitarët.

Pasuria nr. 269/4 është regjistruar në, volum 1, faqe 4 me dokumentacion shoqërues jo të rregullt.

- Ka kryer regjistrime për AMTP nr. 16756, për sipërfaqen 6700 m² tokë arë.

Për zërat e pasurive nr. 129, 147, 265 dhe 263, nuk janë vendosur kufitarët, po kështu janë dhe në formularin nr. 6. Në të gjitha rastet, planet e rilevimit janë të pa firmosura nga pronari i pasurisë.

Pasuria nr. 269/11 është regjistruar në, volum 1, faqe 2 dhe 269/7 volumi 1 faqe 3, me dokumentacion shoqërues jo të rregullt.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56, të ligjit 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar ,UKM nr. 1 datë 31.01.2007, “Për procedurat e regjistrimit në ZVRPP” dhe UKM nr. 2, datë 8.4.2009, “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme të fituara me AMTP” dhe Urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 61, datë 02.8.1999, “Për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme në raste të veçanta”

8. ■ me detyrë hartograf, pasi;

- Ka pranuar dokumentacionin dhe ka kryer veprime për regjistrime fillestare nga ristrukturimi i NB-së dhe Ndërmarrjes Pyjore me vendimin nr. 59, datë 01.10.2002 nga Komisioni i Ndarjes së tokës pranë Këshillit të Qarkut për arsye se nuk janë trajtuar me tokë bujqësore nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991.

- në 12 raste, dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesit për sipërfaqet 16750 m² tokë “arë”, kanë qen jo të rregullta si:

- Plan vendosjet shkalla 1: 2500 janë pa sipërfaqe, të punuar nga, hartografe ■

- Planet e rilevimit për pasurit e aplikuar janë pa numër pasurie dhe pa treguesit e hartës

- Për të 8 rastet, planet e rilevimit dhe të vendosjet janë të pa firmosur nga aplikuesi.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 56, të ligjit 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar ,UKM nr. 1 datë 31.01.2007, “Për procedurat e regjistrimit në ZVRPP”, UKM nr. 2 , datë 08.04.2009, “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme të fituara me AMTP”, VKM 159, datë 21.3.2006, “Për mbylljen e njësisë së menaxhimit të projektit për sistemimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe transferimin e funksioneve të saj ZQRPP”

9. Për punonjësit ■ me detyrë ish-jurist dhe ■ me detyrë ish-jurist, nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me

këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre. Në kushtet kur mosushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre ka ndikuar në funksionimin administrative të institucionit, atëherë ngarkohet ZQVRP të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH-së për këta persona.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 248 “Shpërdorimi i detyrës”, të bëhet kallëzim penal ndaj dy personave të mëposhtëm:

1. ■ me detyrë ish-regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier.

2. ■ me detyrë juriste në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, për arsye se:

kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar neni 44, pika “b” dhe urdhrin e kufizimit nr. 1483, datë 23.7.2008 të ZVRPP Fier.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Pullumb Beqiraj, Niko Nako, Piro Imeraj, Sotir Kosdine dhe Artan Mirashi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj dhe Drejtori Juridik dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT